



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1082/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Siniša Simijonović anëtarë i Këshillit të Vendvotimit nga subjekti politik G.I.Srpska, dega në Prekovic Novobërd, paraqitur kundër subjektit politik Demokratska Inicijativa, për shkak të publikimit të rezultateve përfundimtare për anëtarë të kuvendit komunalë në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Siniša Simijonović anëtarë i Këshillit të vendvotimit në Prekovic Novobërd nga subjekti politik G.I.Srpska.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 03.12.2013, nga Siniša Simijonović anëtarë i Inicijativës Qytetare Srpska dega në Novobërd, në të cilën pretendon se Zgjedhjet për Kuvend Komunal me 03.11.2013 Qendra e votimit 1403-01D Novobërd, Siniša Simijonović anëtar i Inicijativës Qytetare Srpska (G.I.Srpska) deklaroi se gjatë shënimit të votave ka ardhur deri tek permutacioni (ndryshimi) në mes të kandidatit Boban Stojanović nga Demokratska Inicijativa me nr 13 dhe Sreten Gigićme nr.11.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP-i konstatoi nga shkresat e lëndës se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë sepse parashtruesi i ankesës nuk ka ofruar asnjë provë dhe dëshmi bindëse që është bërë një shkelje e tillë, prandaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe neni 3.6 pika c) të Rregullores së PZAP-I lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 1082/2013 më datën 06.12.2013



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24(njëzetekatër) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.